

**VENDIM**  
**Nr. 517, datë 16.8.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE  
MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2/I, vlera “...13 000 lekë...” bëhet “...14 000 lekë...”.

2. Efektet financiare, për vitin 2012, që rrjedhin si rezultat i rritjes së pagave, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2012.

3. Efektet financiare, për vitin 2012, që rrjedhin si rezultat i ndryshimeve në pozicionet e punës së mësuesve dhe edukatorëve, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për arsimin parauniversitar, për vitin 2012.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**